

20140441305

LIGJ PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR VEPRIMTARI FILMIKE

Neni 1

Në Ligjin për veprimtari filmike ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 82/13 dhe 18/14), në nenin 15 pas paragrafit (2) shtohet paragraf i ri (3), si vijon:

"(3) Për emërimin e drejtorit publikohet shpallje publike që shpallet në së paku tri gazeta ditore të cilat botohen në tërë territorin e Republikës së Maqedonisë, nga të cilat njëra botohet në gjuhën që e flasin së paku 20% e qytetarëve të cilët flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga gjuha maqedonase."

Paragrafi (3) bëhet paragraf (4).

Paragrafi (4), i cili bëhet paragraf (5) ndryshohet si vijon:

"(5) Për drejtor mund të emërohet personi i cili i plotëson këto kushte:

- 1) është shtetas i Republikës së Maqedonisë;
- 2) në momentin e emërimit me aktvendim të plotfuqishëm gjyqësor nuk i është shqiptuar dënim apo sanksion i kundërvajtjes ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë apo detyrës;
- 3) ka marrë së paku 240 kredit sipas SETK ose ka përfunduar shkallën VII/1 nga sfera e filmit ose të shkencave shoqërore ose fakultet juridik me provim të dhënë të jurisprudencës ose fakultet ekonomik;
- 4) ka minimum pesë vjet përvojë pune në sferën e filmit ose drejtësisë ose ekonomisë;
- 5) posedon një nga certifikatat ose vërtetimet ndërkombëtarisht të njohura si në vijim për njohje aktive të gjuhës angleze jo më të vjetër se pesë vjet:
 - TOEFL IBT së paku 74 pikë,
 - IELTS (IELTS) - së paku 6 pikë,
 - ILEC (ILEC) (Cambridge English: Legal) - së paku niveli B2 (B2),
 - FCE (FCE) (Cambridge English: First) - të dhënë,
 - BULATS (BULATS) - së paku 60 pikë ose
 - APTIS (APTIS) - së paku niveli B2 (B2) dhe
- 6) ka dhënë test psikologjik dhe test për integritet".

Neni 2

Drejtori i Agjencisë, i emëruar deri në ditën e fillimit të zbatimit të këtij ligji vazhdon ta ushtrojë funksionin deri në përfundim të mandatit për të cilin është emëruar.

Neni 3

Dispozitat nga nenin 1 të këtij ligji të cilat kanë të bëjnë me kushtin për njohje të gjuhës së huaj do të fillojnë të zbatohen pas dy vitesh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë", ndërsa do të fillojë të zbatohet pas një viti nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.